

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

**Auditim i avancuar dhe
siguria
(zgjidhjet)**

P10

Data 25/01/2020

Detyra 1

Ju jeni menaxher i auditimit në firmën e auditimit Ala & Co. Partneri i angazhimit Burim Ala, ju ka ftuar për të diskutuar për klientin e ri të auditimit. Jeni përcaktuar si menaxher i auditimit të Hotel Kristal Grup (Kristal Grup) për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2018. Grupi operon me një zingjir të hoteleve luksoze në tërë Kosovën. Mirëpo si pjesë e strategjisë së tyre të rritjes, Grupi kishte blerë një hotel tjetër në Tiranë. Tani është janari 2019 dhe ju sapo keni pasur takimin e planifikimit me partnerin e auditimit, Albert Neta drejtorin ekzekutiv dhe Liza Tana, drejtorin financiar të Kristal Grup. Nga diskutimet e detajuara me ata, ju keni përfutur informatat në vijim:

Të përgjithshme

Kristal Grup zotëron pesë hotele në Kosovë dhe një në Tiranë i cili ishte blerë në shtator 2018. Secili hotel operon përmes entitetit të veçantë ligjor dhe Kristal Grup zotëron 100% të secilit entitet. Grupi përgatit pasqyrat financiare të konsoliduara në baza vjetore. Zyra kryesore e gjindet në Prishtinë. Në vitin 2018, Grupi kishte gjithsej të hyra prej €90 milion (2017: €80 milion), dhe fitim operativ prej €8,500,000 (2017: €11,000,000). Liza shpjegoi se të gjitha hotelet kishin pasur performancë të mirë gjatë vitit.

Ekipi i financave

Secili hotel e ka ekipin e tij të financave, përfshirë kontabilistin. Në fund të secilit muaj, përgatitet nga një pako e raportimit nga kontabilisti, përfshirë pasqyrat meanxheriale, harmonizimet kryesore dhe komentet të detajuara si kishte performuar hoteli gjatë muajit dhe si janë përmbushur indikatorët kyç të performancës për muajin përkatës. Secila pako e raportimit dërgohet në zyrën kryesore në Prishtinë e cila pastaj rishikohet nga kontabilisti kryesor i Grupit i cili kryen harmonizime shtesë. Kontabilisti i Grupit po ashtu i përgatit edhe pasqyrat e konsoliduara vjetore. Mirëpo Liza ju ka informuar se kontabilisti i Grupit kishte dhënë dorëheqje në nëntor të 2018 sepse nuk mund të përballonte me presionin e punës. Ajo ende nuk ka mundur të gjente një zëvendësues të përshtatshëm. Liza ju ka pyetur nëse ju mund të ndihmoni në finalizimin e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2018 pasi që ekipi i saj e ka të vështirë të gjej kohë për këtë punë.

Blerja e re

Hoteli në Tiranë ishte blerë në shtator 2018 për €8,500,000 dhe do të përfshihet në pasqyrat financiare të konsoliduara me 31 dhjetor 2018. Blerja e hotelit ishte financuar nga një kredi nga banka. Drejtori ekzekutiv shpjegoi se ky ishte një investim domethënës për Grupin dhe se janë shpenzuar edhe €2 milion të tjerë në shpenzime kapitale për tu siguruar se hoteli i përmbushë standardet e larta të Grupit. Drejtori ekzekutiv ju ka ftuar të gjithë ekipin e auditimit të udhëtoni në Tiranë në hapjen e hotelit që do të bëhet në mars 2019 si mysafirë të tij. Ai po ashtu ju ka siguruar se do të trajtoheni mirë përgjatë qëndrimit atje.

Vlerësimi i pronave të hoteleve

Politika e Grupit është të vlerësoj tokat dhe ndërtesat me vlerën e drejtë. Llogaritja e vlerës së drejtë dhe shpërndarja e vlerës së drejtë në toka dhe ndërtesa kërkon gjykim domethënës. Për këtë arsye Grupi ka angazhuar ekspert profesionist të vlerësimeve për të vlerësuar tokat dhe ndërtesat me 31 dhjetor 2018. Tokat dhe ndërtesat në atë datë janë vlerësuar me €110 milion, që përfaqëson një rritje në rivlerësim prej €12 milion.

Kreditë dhe huatë

Gjatë vitit 2018, Grupi kishte huazuar €10,500,000 për të financuar blerjen e hotelit në Tiranë dhe për të përfunduar punët e rinovimit. Huaja duhet të paguhet brenda 10 vitesh dhe Grupi duhet të respektoj disa kushte strikte të kredisë. Banka kërkon nga Grupi të dorëzoj pasqyra menaxheriale tremujore dhe nëse këto kushte të kredisë shkelen nga Grupi, huaja mund të kërkohej të paguhet menjëherë. Liza ju ka informuar se Grupi është duke pasur vështirësi në përgatitjen dhe dorëzimin me kohë të raportit tremujor që përfundon me 31 dhjetor 2018.

Kërkohet:

(a) Përshkruani PESË rreziqe kyçe të auditimit lihur me Grupin Kristal dhe rekomandoni nga tre testet të auditimit për të adresuar secilin rrezik.

Shënim: Paraqitni përgjigjet tuaja në tri kolona: rreziku i auditimit; arsyeja pse është rrezik; testet e propozuara të auditimit. (21 pikë)

(b) Përshkruani procedurat shtesë që auditori duhet të kryej lidhur me angazhimin e ekspertit të vlerësimit të tokave dhe ndërtesave të grupit. (4 pikë)

(c) Shpjegoni kërcënimet e mundshme etike lidhur me angazhimin në Kristal Grup dhe rekomandoni masat mbrojtëse përkatëse. (5 pikë)

[Total 30 pikë]

Zgjidhja 1
(a)

Rreziku i auditimit	Arsyeja	Testet e propozuara të auditimit
Viti i parë i auditimit	Mungesë e njohurisë dhe përvojës në auditimit të klientit	Lexoni PF të fundit dhe raportine auditorit. Kryeni planifikimin e duhur dhe përftoni njohuri për entitetin dhe mjedisin e tij Përdorimi i personelit senior dhe me përvojë për të kryer punën e auditimit në fusha me rrezik më të lartë Angazhim i numrit më të madh të personelit Kryerja e procedurave të pavarura në saldot fillestare
Njohja e të hyrave	Presioni për të mbajtur të hyrat në nivel të kënaqshëm edhe nëse kushtet ekonomike përkeqësohen Të hyrat janë fusha kyçe me rrezik për tu siguruar se shitjet nuk fryhen artificialisht	Kryerja e procedurave analitike duke llogaritur ndaras të hyrat nga akomodimit, restorani, etj. Diskutimi i çfardo luhatje të koeficientëve me menaxhmentin Përzgjedhja e një mostre të shitjeve nga libri kryesor dhe ndjekja deri te raporti i arkës fiskale Rishikimi i kreditnotave të lëshuara në fund të vitit Konsiderimi i mashtrimit për shkak të njohjes së të hyrave
Kontabilisti kryesor i grupi ka dhënë dorëheqje dhe nuk është zëvendësuar ende	Për shkak të largimit të kontabilistit nuk janë rishikuar pakot e raportimit që nga ajo kohë – kjo e rrit rrezikun e kontrollit Gjithashtu nuk janë përgatitur pasqyrat financiare të konsoliduara për vitin deri me 31 dhjetor 2018. Rritja e ngarkesës së punës në zyrat kryesore dhe humbja e personelit të rëndësishëm rritë rrezikun e anomalisë materiale	Ekipi i auditimit duhet të jetë i vëmendshëm gjatë gjithë auditimit për anomalitë e mundshme për shkak të mashtrimit ose gabimit Diskutoni me drejtorin ekzekutiv dhe menaxherin financiar nëse ata do të jenë në gjendje të ofrojnë pasqyrat me kohë Pasi që ky është viti i parë i auditimit, duhet të kryhen testet e kontrolleve në hotele dhe në zyrat kryesore
Tokat dhe ndërtesat janë vlerësuar në €110 milion, me një rritje të rivlerësimit prej €12 milion.	Grupi ka politika të rivlerësimit të tokave dhe ndërtesave dhe ky vlerësim është kryer në fund të vitit. Tokat dhe ndërtesat mund të nën/mbi vlerësohen nëse nuk janë kryer sipas	Diskutoni me menaxhmentin për procesin e vlerësimit. Ky proces duhet të jetë në pajtueshmëri me SNK 16. Në pajtueshmëri me SNA 620 Përdorimi i punës së ekspertit të auditimit, duhet të sigurohemi se eksperti ka aftësitë, kualifikimet dhe

	SNK 16 dhe nëse nuk janë shpalosur si duhet	ekspertizën e nevojshme për të kryer vlerësimin. Gjithashtu është i pavarur nga kompania. Sigurohuni që supozimet e përdorura në vlerësim janë të përshtatshme Krahasoni vlerësimin e tokës dhe ndërtesave me pronat e ngjashme në atë zonë Sigurohuni që zhvlerësimi është bazuar në shumat e rivlerësuar Rishikikoni që të gjitha pasuritë në kategori janë rivlerësuar Rishikoni shënimet e PF nëse ka shpalosje të duhura sipas SNK 16
Blerja e hotelit në Tiranë dhe do të konsolidohet së bashku me kompanitë tjera	Konsolidimi duhet të bëhet sipas SNRF 3 – Kombinimet biznesore. Përveç kësaj pasi që hoteli është blerë gjatë vitit, vetëm aktiviteti prej shtator-dhjetor 2018 duhet të përfshihet në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave gjithëpërfshirëse Duhet të shihet nëse është njohur ndonjë zë i mirë nga blerja.	Inspektoni dokumentet ligjore të blerjes së hotelit për tu siguruar se është blerë nga Grupi. (ekzistenca, të drejtat dhe obligimet) Ndjekni pagesat për blerje deri te raporti i bankës Llogaritni zëri në mirë, nëse ka dhe nëse është trajtuar si duhet në pasqyra financiare Kontrolloni nëse ka pasur ndonjë dëmtim të zërit të mirë dhe nëse është bërë sipas SNK 36 Rishikoni PF për katër muaj (shtator-dhjetor) për tu siguruar se nuk është përfshirë ndonjë aktivitet tregtar pasi që hoteli do të hapet në masrs 2019 Sigurohuni që shpenzimet kapitale janë kapitalizuar si duhet në PF në pajtueshmëri me SNK 16
Janë shpenzuar €2 milion për shpenzime kapitale lidhur me hotelin e blerë	Shpenzimet kapitale janë kapitalizuar si duhet në PF në pajtueshmëri me SNK 16 dhe nuk janë shpenzuar në pasqyrën e të ardhurave	Merrni listën e shpenzimeve kapitale prej €2 milion. Përzgjedhni një mostër dhe ndjekni shpenzimet deri te faturat e blerjes dhe pagesa në bankë Sigurohu që shpenzimet kapitale janë kapitalizuar si duhet në PF në pajtueshmëri me SNK 16. Sigurohuni që shpenzimet e kapitalizuara nuk janë zhvlerësuar, pasi që hoteli do të fillojë punën vitin tjetër. Përzgjedhni një mostër të shpenzimeve të riparimit dhe mirëmbajtjes dhe sigurohuni se nuk janë kapitalizuar.
Shkelja e kushteve të kredisë	Kredia është dhënë me kushte dhe nëse	Duhet të jeni të vëmendshëm në fusha më subjektive dhe të cilat

	kompania shkel këto kushte, kredia mund të ndërpritet dhe të kërkohet të kthehet menjëherë. Prandaj drejtorët mund të jenë të ndikuar për të paraqitur PF në mënyrë më të favorshme se gjendja e vërtetë. Gjithashtu kompania ka vështirësi të përgatis pasqyrat menaxheriale për qëllime të bankës.	kërkojnë gjykim nga menaxhmenti siç është rivlerësimi i tokës dhe ndërtesave dhe njohja e të hyrave. Rillogaritni kredinë bankare dhe vlerësoni nëse ka rrezik që kushtet e kredisë të shkelen nga kompania. Inspektoni korrespondencat me bankën për të vlerësuar nëse ka çështje të diskutuara për kushtet e kredisë dhe ripagesën.
--	--	---

(b)

SNA 620 Përdorimi i punës së ekspertit të auditorit, përcakton procedura shtesë kur planifikohet përdorimi i punës së një eksperti:

Përvoja e mëparshme e ekspertit

Diskutimi me ekspertin

Njohuria dhe kualifikimet e ekspertit

Anëtarësia në ndonjë organizatë profesionale

Licensa e përshtatshme

Raportet e mëparshme dhe publikimet tjera nga eksperti

Pavarësia e ekspertit nga kompania

Njohuria e ekspertit me SNK 16, metodat dhe supozimet

(c)

Çështja	Kërcënimi	Masat mbrojtëse
Ftesa nga drejtori ekzekutiv në hapjen e hotelit dhe trajtimi i stafit të auditimit gjatë qëndrimit	Interesi personal (vetiak)	Partneri i auditimit duhet të përcaktoj vlerën e udhëtimit dhe akomodimit, mirëpo duke supozuar se është domethënëse, partneri duhet të refuzoj udhëtimin Nëse është e domosdoshme vizita, firma e auditimit duhet të mbulojë të gjitha shpenzimet

Detyra 2

Ju jeni menaxher i auditimit në firmë e auditimit L&M. Situatat e mëposhtme janë paraqitur në tri angazhime të ndryshme të klientëve të firmës tuaj. Tani është 1 prill 2019 dhe viti financiar në secilin nga rastet e mëposhtme është 31 dhjetor 2018.

IT Pro

Gajtë vitit IT Pro ishte angazhuar nga një konsumator për të testuar aftësinë e sistemeve të teknologjisë informative për t'i bërë ballë sulmeve nga hakerët. Konsumatori pretendon se IT Pro për shkak të neglizhencës së tyre i kishte "rëzuar sistemet" e saja për tre ditë që kishte rezultuar me tre ditë shitje të humbura. Konsumatori kishte inicuar rastin gjyqësor kundër IT Pro për neglizhencë. Ju keni rishikuar korrespondencat lidhur me pretendimin dhe i keni diskutuar me avokatët e kompanisë IT Pro. Avokatët kanë pohuar se ka mundësi të madhe që konsumatori i IT Pro të fitoj rastin dhe kanë vlerësuar një humbje prej €1,500,000 deri €1,600,000. Drejtorët e IT Pro nuk kanë regjistruar ndonjë provision në pasqyrat financiare pas që besojnë se IT Pro do të fitoj këtë rast. Fitimi para tatimit i IT Pro është €12,000,000 dhe materialiteti i llogaritur ishte 10% i fitimit para tatimit.

Natyra-a Shpk

Natyra është kompani që mbështetet vazhdimisht në kredi bankare për të financuar aktivitetet e saj operative. Kredia aktuale përfundon me 30 shtator 2019. Drejtorët besojnë se kredia do të rinovohet me kushte të ngjashme edhe pse nuk kanë ndonjë marrëveshje me bankën për vazhdim automatik. Drejtorët kanë përgatitur parashikimin e rrjedhës së parasë për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 bazuar në supozimet se kredia do të rinovohet. Këto parashikime tregojnë se kompania do të jetë në gjendje të paguaj të gjitha detyrimet kur bëhen të pagueshme. Drejtorët janë pajtuar që të përfshijnë një shënim në pasqyra financiare për të shpalosur ngjarjen në tërësi. Raporti i auditimit është planifikuar të nënshkruhet me 30 qershor 2019.

Arbana Shpk

Arbana mban regjistrat e stokeve sipas sistemit të vazhdueshëm dhe si rrjedhojë kompania nuk bën numërim fizik të stokeve në fund të vitit. Me 5 shkurt 2019, një zjarr në depo shkatërroi stoqet e kompanisë dhe fletëdërgesa/pranimet e stokeve. Nuk mund të kryheshin procedura alternative të kënaqshme. Kompania kishte përfshirë si saldo përfundimtare të stokeve një shifër prej €805,000 në pasqyrat financiare. Ky shumë paraqet 5% të pasurive totale dhe 20% të fitimit para tatimit.

Kërkohet:

(a) Vlerësoni tri situatat e mësipërme dhe tregoni nëse duhet të modifikohet raporti i auditimit. Arsyetoni përfundimet tuaja dhe përshkruani modifikimin e raportit, nëse duhet. (15 pikë)

(b) Rekomandoni procedura shtesë të cilat duhet të kryhen lidhur me parashikimin e rrjedhës së parasë së Natyra-a Shpk para se të nënshkruhet raporti i auditimit. (10 pikë)

[Total: 25 Pikë]

Zgjidhja 2

(a) IT Pro

SNK 37 udhëzon që një provision duhet të njihet nëse plotësohen 3 kriteret e mëposhtme:

1. Ka një obligim të tanishëm që lind nga ngjarjet në të kaluarën
 - Incidenti ka ndodhur gjatë vitit, prandaj është një ngjarje në të kaluarën. Përveç kësaj duket se është një obligim që IT Pro ka një detyrim
 2. Ka mundësi të ndodhë një dalje e burimeve (pagesë) për të përmbushur atë obligim
 - Nga informatat e ofruara, avokati beson se konsumatori do ta fitoj rastin dhe ka vlerësuar se shuma do të jetë €1,500,000 deri €1,600,000.
 3. Mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i obligimit
 - Avokati ka vlerësuar se pagesa do të jetë prej €1,500,000 deri €1,600,000. Edhe pse ka një diferencë prej €100,000, kjo nuk është materiale.
- Pasi që të gjitha kriteret e mësipërme janë plotësuar, duhet të njihet një provision në vlerë prej €1,550,000 (pika e mesme) në PF sipas SNK 37.
 - Pasi që klienti nuk është duke pranuar të regjistroj provizionin, kjo do të rezultoj me raport të modifikuar të auditimit për shkak të mosmarrëveshjes me klientin
 - Provizionin është material por nuk është përhapës prandaj opinion do të jetë me rezervë me 'përveç për'.

Natyra Shpk

- Modifiko raportin e auditimit, por jo opinionin
- Pasi që drejtorët pajtohen të shpalosin në tërësi çështjen dhe kanë përgatitur parashikimet e rrjedhës së parasë, nuk ka ndonjë mosmarrëveshje me menaxhmentin
- Ka një pasiguri materiale lidhur me vijimësinë që është fundamentale për përdoruesit e PF
- Sipas SNA 570, nëse ka shpalosje të mjaftueshme për pasigurinë materiale, auditori do të jep një opinionin pa rezervë dhe do të përfshijë një paragraf të veçantë me titull "Pasiguria materiale lidhur me vijimësinë"
- Ky seksion do të tërheq vëmendjen në shënimin e PF që diskuton çështjen dhe se auditori nuk e ka modifikuar opinionin për këtë çështje

Arbanka Shpk

- Modifiko raportin dhe opinionin për shkak të pamundësisë të grumbullohen dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit (kufizim i objektit të auditimit)
- Shuma e stoqeve është materiale pasi që është më e lartë se 5-10% të fitimit para tatimit dhe 1-2% e pasurive totale
- Rrjedhimisht, efekti i mundshëm në PF mund të jetë material por ka pak gjasa të jetë përhapës pasi që stoqet mund të mos jenë përqindje domethënëse në pasuritë e entitetit
- Opinioni duhet të rezervohet dhe të përfshihet paragrafi i bazës për opinion me rezervë për të shpejguar arsyet e pamundësisë së grumbullimit të dëshmive të auditimit

(b) Procedurat shtesë për parashikimin e rrjedhës së parasë:

- Hipoteza e vijimësisë duhet të vlerësohet për 1 vit nga data e PF
- Në këtë rast auditorit duhet të konsideroj periudhën deri me 30 qershor 2020
- Duhet të presim që menaxhmenti të shtrij parashikimin pas 31 dhjetor 2019 për gjashtë muaj shtesë deri me 30 qershor 2020
- Auditori duhet të rishikoj parashikimin dhe të konsideroj çështjet e mëposhtme:
 - o Krahaskimi i performancës së parashikuar me rezultatet aktuale të periudhës së mëparshme
 - o Krahaskimi i koeficientëve kyç të kapitalit qarkullues sipas parashikimit me aktualet e periudhës së mëparshme (psh ditët e LLA, ditët e LLP, ditët e stoqeve)

- o Kontrollimi i saktësisë matematikore të parashikimit
- o Përputhja e saldove fillestare të parasë me raportet e bankës
- o Kryerja e analizave të ndjeshmërisë:
 - Psh “çka nëse” të hyrat kanë rënie prej 10%?
 - Konsidero ndikimin e çfardo ngjarje pasuese që mund të kërkojnë korrigjim në parashikim

Detyra 3

(a) Përshkruani në mënyrë kritike rëndësinë e procedurave të kontrollit të cilësisë në një angazhim të auditimit. (10 pikë)

(b) A&B Shpk prodhon dhe shet dritare. Ju jeni senior i auditimit për këtë angazhim dhe jeni duke punuar në auditimin e llogarive të arkëtueshme për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2018. Materialiteti është llogaritur në €75,000. Një mostër e tri saldove të llogarive të arkëtueshme është përzgjedhur në mënyrë të rastësishme dhe janë dërguar kërkesat për konfirmim te tre konsumatorët siç janë paraqitur më poshtë:

Llogaria e arkëtueshme	Saldoja sipas librave të klientit	Saldo sipas konfirmimit	Komente
DEF Co	€315,100	£235,939	Shënimi 1
TUI Shpk	€565,000	€385,000	Shënimi 2
KOK Shpk	€479,000	€414,000	Shënimi 3

Shënimi 1

Gjatë procesit të konfirmimit, është vërejtur se DEF Co faturohet dhe paguan në Funta. Shuma e konfirmuar prej £235,939, përfshinë faturat për produktet e pranuar deri me 31 dhjetor 2018 që kanë vlerën prej €315,100 minus pagesat e bëra me 28 dhjetor 2018 në vlerë prej €50,000 (£44,500). Pagesa prej €50,000 (£44,500) ishte pranuar nga A&B Shpk me 4 janar 2019. Saldoja prej £235,939 paraqet shumën €265,100 të ripërkthyer sipas normës së këmbimit Euro/GBP: €1/£0.89 me 31 dhjetor 2018.

Shënimi 2

Diferenca ka të bëjë me faturat e lëshuara nga A&B Shpk në vlerë prej €180,000 lidhur me shërbimet prej nëntor 2018 deri shkurt 2019. Ka pasur vonesë në dërgimin e këtyre faturave prandaj këto fatura ishin regjistruar nga TUI Shpk në shkurt 2019. Shuma prej €180,000 ishte njohur si e hyrë nga A&B Shpk për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2018.

Shënimi 3

Data në letyrën e konfirmimit të KOK Shpk ishte 6 janar 2019 e cila paraqet kredit-notat e pranuar gjatë javës së parë të janarit në vlerë prej €65,000. Këto kredit-nota ishin regjistruar në regjistrat e kontabilitetit të A&B në janar 2019 por kanë të bëjnë me mallrat e kthyer në nëntor 2018.

Kërkohet:

Lidhur me procesin e konfirmimit të llogarive të arkëtueshme të A&B për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2018:

- (i) Përshkruani procedurat kyçe që duhet të kryhen lidhur me të TRE rastet e mësipërme (9 pikë)
- (ii) Përgatitni korrigjimet e propozuara në ditar për të çështjet e mësipërme. (6 pikë)

[Total: 25 Pikë]

Zgjidhja 3

Në mënyrë që të sigurohet se të gjitha angazhimet për siguri kryhen në mënyrë efektive dhe efikase është e rëndësishme që auditori të kryej procedura të kontrollit të cilësisë

- SNA 220 Kontrolli i cilësisë për një auditim të pasqyrave financiare thekson: "Partneri i angazhimit duhet të sigurohet se janë ndjekur procedura të duhura lidhur me pranimin ose vazhdimin e marrëdhënies me klientin dhe duhet të dokumenton përfundimet e arritura në ato rrethana".
- Secili auditor duhet të themeloj dhe ruaj procedura të kontrollit të cilësisë që janë të përshtatshme për ato rrethana
- Programi i inspektimit për sigurimin e cilësisë ka objektivë sigurimin se të gjitha angazhimet kryhen në pajtueshmëri me politikat dhe procedurat relevante
- Është me rëndësi që të përmushen pritjet e përdoruesve që auditori ofron shërbime mbi të cilat përdoruesit do të mbështeten
- Puna kryhet me standarde të larta dhe ofron vlerë për para, është efektive dhe efikase
- Ato rrisin dhe përmirësojnë besimin në profesion
- Mbrojnë auditorët kundër pretendimeve për neglizhencë dhe procedurave disiplinore
- Sigurojnë se angazhimet pranohen vetëm për shërbimet që firma mund ti ofrojë dhe ka kompetencat e duhura
- Sigurojnë se auditorët e mëparshëm janë kontaktuar dhe nuk ka pasur rrethata të pazakonta lidhur me largimin ose dorëheqje e auditorëve

(b) (i) Shënimi 1:

- Konfirmo se faturimi është bërë në funta (£)
- Ripërkthe €265,100 duke përdorur normat e pavarura të këmbimit valutor në datën e faturimit
- Përputh pagesat prej €50,000 (£44,500) dhe ndjei në raportet e bankës
- Sigurohu se pagesa prej €50,000 (£44,500) ka të bëjë me faturën e periudhës së kaluar
- Konfirmo se pagesa e pranuar nga konsumatori është pas fundit të vitit
- Sigurohu që salodoja e regjistruar në fund është e saktë
- Sigurohu që çfardo fitim/humbje nga këmbimi valutor është përfshirë në pasqyrën e të ardhurave

Shënimi 2:

- Përputh shumat me fatura
- Verifiko periudhën e faturave për nëntor dhe dhjetor 2018
- Verifiko shitjet e produkteve kanë ndodhur në këtë periudhë
- Kupto pse ka pasur vonesë në dërgimin e faturave dhe konsidero implikimet tjera
- Nëse shitjet kanë ndodhur në mënyrë të barabart përgjatë periudhës 4 mujore – duhet të korrigjohet prerja me 31 dhjetor 2018

Shënimi 3:

- Përputh shumat dhe detajet me kredi-nota
- Konfirmo se këto kredi lidhen me shitjet e periudhës së kaluar
- Konfirmo se mallrat janë kthyer në nëntor 2018 – përputh me fletpranimet e nënshkruara
- Konfirmo pastime në ditar të këtyre kredit notave në janar 2019
- Bisedo me menaxhmentin pse ka pasur vonesë në regjistrimin e notave të kreditit.

(ii) TUI Shpk

D. Shitjet 90,000

K. Llogaria e arkëtueshme 90,000

KOK Shpk

D. Kthimet nga shitjet 65,000

K. Llogaria e arkëtueshme 65,000

Detyra 4

(a) SNA 250 – Dëshmitë e auditimit, kërkon nga auditorët të përftojnë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit. Përshtatshmëria e dëshmive është masë e cilësisë dhe besueshmërisë së dëshmive të auditimit.

Kërkohet:

Shpjegoni katër çështje që auditorët duhet të konsiderojnë lidhur me besueshmërinë e dëshmive të auditimit. (5 pikë)

Ju jeni seniori i auditimit të Linda Shpk për vitin që përfundoi me 31 mars 2019. Linda zotëron dhe menaxhon dhjetë dyqane të sendiuçëve. Sendiuçët përgatiten sipas kërkesës së konsumatorëve duke përdorur përbërësit e freskët që pranohen nga furnitorët në baza ditore. Ju jeni në dijeni që drejtorët e kompanisë janë duke diskutuar mundësitë e zgjerimit të biznesit dhe janë duke shikuar po ashtu listimin në bursë. Rregullat për listim në bursë kërkojnë pajtueshmëri me parimet e qeverisjes së korporatës dhe drejtorët kanë treguar se besojnë se janë duke i përmbushur këto parime.

Ju i keni dokumentuar çështjet në vijim lidhur me qeverisjen e korporatës së kompanisë Linda:

- Bordi përbëhet nga gjashtë drejtor; katër ekzekutiv të cilët e kishin themeluar kompaninë dhe dy joekzekutiv të cilët kishin ardhur tash së voni në kompani.
- Secili drejtor ka një fushë specifike të përgjegjësisë dhe vetëm drejtori financiar rishikon pasqyrat financiare dhe buxhetet.
- Pasi që bordi është relativisht i vogël, në mënyrë që të kursehen kostot, drejtori ekzekutiv kishte marrë rolin e kryesuesit të bordit.
- Kryesuesi i bordit po ashtu themeloi komitetin e auditimit dhe është anëtarë i këtij komiteti së bashku me drejtorin financiar dhe disa drejtor joekzekutiv.
- Drejtori financiar dhe kryesuesi i bordit marrin vendime për caktimin e auditorëve të jashtëm dhe tarifat e tyre.
- Për të kursyer kosto, funksioni i auditimit të brendshëm nuk ishte themeluar.
- Kompenzimi i drejtorëve ekzekutiv propozohet nga drejtori financiar dhe aprovohet nga kryesuesi i bordit. Ata paguhën me një pagë vjetore si dhe një shumë domethënëse të bonusit të bazuar në të hyrat e kompanisë.

Auditimi është afër përfundimit dhe menaxheri i auditimit është duke draftuar letrën e menaxhmentit për të komunikuar çështjet relevante të auditimit tek personat e ngarkuar me qeverisjen.

Kërkohet:

(b) SNA 265 – Komunikimi i mangësive në kontrole të brendshme të personat e ngarkuar me qeverisjen dhe menaxhmenti, kërkon nga auditorët të komunikojnë mangësitë domethënëse në kontrole të brendshme që janë identifikuar gjatë auditimit tek personat e ngarkuar me qeverisjen. Identifikoni dhe shpjegoni tiparet që kërkohen për tu siguruar se këto komunikime janë efektive. (5 pikë)

(c) Diskutoni PESË mangësi në qeverisjen e korporatës në kompaninë Linda dhe ofroni rekomandime për të përmirësuar këto mangësi. (10 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja 4

(b) Besueshmëria e dëshmimeve të auditimit

- Burimet e jashtme: informatat nga burimet e jashtme (psh konfirmimet e konsumatorëve) janë më të besueshme se dëshmitë e brendshme (psh regjistrat e shitjes)
- Auditori: informatat e gjeneruara nga auditorët janë më të besueshme se ato indirekte (psh auditori do të donte që vet të inspektoj dokumentet e regjistrimit të automjetit të drejtorit financiar e jo të supozoj ndryshe)
- Sistemet e kontrollit: dëshmitë që merren nga regjistrat e kompanisë nëse sistemi i kontrollit funksion në mënyrë efektive janë më të besueshme (psh auditori mund të mbështetet në listën e numrimit të stoqeve nga klienti nëse më parë ka testuar kontrollet mbi numërimin dhe sigurohet se ato funksionojnë si duhet)
- Dëshmitë e shkruara: dëshmitë e përfutuara në formë të shkruar janë më të besueshme se përfaqësimet verbale. Kjo është arsyeja pse auditorët përftojnë një letër të përfaqësimit në fund të auditimit.
- Origjinalet: dokumentet origjinale janë më të besueshme se fotokopjet.

(i)

- Raporti duhet ti komunikohet me kohë menaxhmentit për të ndërmarr veprimet e duhura me kohë
- Raporti duhet ti komunikohet në formë të shkruar për të shmangur keqkuptimet
- Raporti duhet ti komunikohet personave të ngarkuar me qeverisjen për tu siguruar se ka autoritet të duhur për të ndërmarr veprime korrigjuese
- Raporti duhet të përfshijë përshkrimin e mangësës, ndikimin e mundshëm dhe rekomandimin për përmirësim
- Përfshijë komentet e menaxhmentit që tregojnë se ato janë pranuar nga menaxhmenti
- Përfshihet kufizimi i përdorimit për të zvogëluar mundësinë që ndonjë palë e tretë të kërkojë të mbështetet në atë raport.

Dobësia	Rekomandimi
Janë vetëm dy drejtor joekzekutiv, më pak se gjysma e anëtarëve. Nuk ka nalansë të duhur për të siguruar se vendimet e bordit vihen në pyetje dhe mbrohen interesat e aksionarëve.	Duhet të caktohen edhe së paku dy drejtor joekzekutiv për të balasuar përbërjen
Vetë drejtori financiar i rishikon pasqyrat financiare dhe buxhetet. Këto duhet i paraqiten bordit dhe ti shpjegohen atyre pasi që PF kanë ndikim në vendimet në të ardhmen	PF duhet ti paraqiten bordit në mënyrë që ata të kuptojnë pozicionin dhe performancën e kompanisë. Kjo do të ndihmojë në vendime të informuara.
Kryesuesi i bordit është po ashtue dhe drejtor ekzekutiv. Duhet të ketë ndarje të duhur në mes të përgjegjësive në krye të kompanisë dhe kryesuesi nuk duhet të zë dy pozitat për shkak se vendimet mbeten ta pasfiduara.	Dikush tjetër duhet të caktohet si kryesues i bordit në pajtueshmëri me praktikën e qeverisjes së korporatës.
Drejtori ekzekutiv/kryesuesi ka themeluar komitetin e auditimit dhe drejtori financiar është anëtarë i këtij komiteti. Ky komitet duhet të përbëhet nga drejtor joekzekutiv për të ruajtur pavarësinë nga anëtarët ekzekutiv të bordit që kanë interes personal në	Komiteti i auditimit duhet të reformohet edhe të përbëhet vetëm nga drejtorët joekzekutiv.

Dobësia	Rekomandimi
kompani	
Drejtori ekzekutiv/kryesuesi dhe drejtori financiar vendosin për kompenzimin dhe caktimin e auditorëve të jashtëm. Kjo duhet të vendoset nga komiteti i auditimit të përbërë nga drejtorët joekzekutiv	Komiteti i auditimit i përbërë nga drejtorët joekzekutiv duhet të jetë përgjegjës për caktimin e auditorëve dhe tarifën e tyre
Nuk ka departament të auditimit të brendshëm me arsyetim se është i kushtueshëm. Ky vendim duhet të mirret vetëm nga komiteti i pavarur i auditimit pasi që të kenë vlerësuar nevojën për funksionin e auditimit të brendshëm	Komiteti i auditimit duhet të vlerësoj nevojën për auditim të brendshëm duke konsideruar faktorët financiar dhe jofinanciar.
Drejtori ekzekutiv/kryesuesi dhe drejtori financiar vendosin për kompenzimin e të gjithë drejtorëve. Drejtorët nuk duhet të vendosin për kompenzimet e tyre për shkak të interesit personal.	Politika e kompenzimit duhet të jenë të drejta dhe transparente. Drejtorët joekzekutiv duhet të vendosin për pagesat e drejtorëve ekzekutiv
Bonuset e lidhura me të hyrat e kompanisë mund të inkurajojnë vendimet afatshkurta dhe joefektive me qëllim të maksimizimit të fitimeve personale duke anashkaluar fitimet afatgjata të pritura nga aksionarët	Kompenzimi i drejtorëve ekzekutiv duhet të strukturohet në atë mënyrë që të përfshijë një pjesë të bonusit të lidhet me performancën afatgjatë të kompanisë